

SHPALLJE

Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet (CCA) – 2021

Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

Kërkesë për Aplikim

Rundi II

Data e shpalljes: 10 shkurt, 2021
Data e mbylljes: 11 mars, 2021
Ora e mbylljes: 17:00

Të nderuar aplikues,

Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet (CCA) fton aplikues për grante që kontribuojnë në përmbushjen e dy objektivave si më poshtë:

- (1) Rritjen e përfshirjes së qytetarëve në identifikimin dhe adresimin e sfidave të komunitetit lokal të grupeve të nënpërfaqësuar veçanërisht: gratë, të rinjtë dhe komunitetet joshumicë; dhe*
- (2) Përmirësimin e bashkëpunimit multietnik për çështje që lidhen me komunitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe qeverive të tyre lokale.*

*Aplikacionet gjithashtu duhet të kontribuojnë kundrejt këtyre **katër rezultateve:***

Rezultati 1: Përfshirje më e madhe qytetare në identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave të komunitetit lokal (me fokus të veçantë të gratë, të rinjtë dhe qytetarë tjerë të papërfaqësuar);

Rezultati 2: Përmirësim i bashkëpunimit multietnik rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet në Kosovë;

Rezultati 3: Bashkëpunim më i mirë ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes komunale;

Rezultati 4: Rritje e kënaqshmërisë qytetare me performancën e komunave të tyre.

Ky është rundi i dytë i aplikimeve për grante të vogla në kuadër të CCA. Në këtë rund, CCA do të ndajë deri në dhjetë (10) grante me vlerë deri në \$11,000 për grant, të negociuara sipas temës dhe aktiviteteve që propozohen nga përfituesi i grantit. Grantet mund të implementohen në gjithë Kosovën, ndërsa inkurajohen iniciativat ndërkomunale.

USAID rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë nga aplikacionet e paraqitura.

Pakoja e aplikimit duhet të përfshijë:

- Formularin e plotësuar të aplikimit **online** (në linkun: <https://grante.dplus.org/>);
- Buxhetin e parashikuar dhe arsyetimin e buxhetit (**vetëm në formatin EXCEL**);
- CV-të e punonjësve kyç të projektit;
- Kopjen valide të certifikatës së regjistrimit në Kosovë;
- Kopjen e statutit të organizatës;
- Numrin fiskal.

Formulari për buxhet dhe instruksionet për marrjen e numrit DUNS mund të shkarkohen nga ueb faqja e D+: <https://dplus.org/grantet/>.

Sesionet informuese

Në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, sesionet informuese do të mbahen në mënyrë virtuale përmes platformës Zoom. Një sesion do të mbahet në gjuhën shqipe dhe një sesion në gjuhën serbe, sipas orarit si në vijim:

Në gjuhën shqipe: **16 shkurt, 2021** (10:30 @Zoom platform: <https://zoom.us/j/96968574455>)

Në gjuhën serbe: **18 shkurt, 2021** (10:30 @Zoom platform: <https://zoom.us/j/96345265379>)

Sesionet informuese do të ofrojnë të dhëna më të hollësishme mbi qëllimin e aktivitetit dhe procedurat për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve. Subjektet e interesuara do të kenë mundësi të parashtrojnë pyetje të tjera shtesë edhe përmes emailit: grants@dplus.org.

Afati i fundit për dërgim të pyetjeve është 19 shkurt, 2021, në orën 17:00. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të vendosen në ueb faqen e D+ (<https://dplus.org/grantet/>), me datën 24 shkurt, 2021 në orën 17:00 hrs.

Afati për aplikim:

Afati i fundit për të aplikuar është **11 mars, 2021, ora 17:00.**

Aplikacionet duhet të plotësohen **vetëm përmes formës online:** <https://grante.dplus.org/>.

Aplikacionet e vonuara:

Formulari i aplikimit online mbyllet në mënyrë automatike në afatin e caktuar, dhe aplikimet e paraqitura në ndonjë formë tjetër nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren në konsideratë në procesin e shqyrtimit.